



**Peace
Corps**

NORTH MACEDONIA

Raport vjetor

2018





Peace Corps

Mesazhi i Drejtorit



Mark Hannafin
Drejtore
Korpusi i paqes - Maqedoni
*(ish-vullnetar i Korpusit të paqes
në Kirgistan 1993-1995)*

“Çdo amerikan i ri i cili është pjesë e Korpusit të paqes dhe i cili punon në një vend të huaj, është i vetëdijshëm se e ndan qëllimin e madh të përbashkët për sigurimin e jetesës së pranueshme për njerëzit, që është themeli i lirisë dhe i paqes”.

— John F. Kennedy

Viti 2018 ishte viti i ndryshimeve, inovacioneve dhe ndërtimit të partneriteteve të reja dhe e gjithë kjo përderisa ishim duke i mbështetur 100 vullnetarë në vend. Drejtore i ri për programin dhe trajnimin Dejvid Rut na u bashkangjiti nga qendra e Korpusit të Paqes dhe freskoi ekipin tonë. Drejtoresha administrative Bina Sheledia erdhi këtu pas disa vitesh të kaluar në Armeni dhe në qendrën e Korpusit të Paqes si përgjegjëse për kontakt me zyrat nacionale të Korpusit të Paqes. Në shtator mirëpritëm grupin e 23-të dhe 48 vullnetarë të rinj dhanë betimin për shërbim.

Në kornizat e partneritetit me Ministrinë e Punës dhe Politikës Sociale ne organizuam takime me vullnetarët tanë dhe me ministren, si dhe me përfaqësues të tjerë nga ministria, me qëllim që të ndajmë praktikat pozitive nga puna në qendrat ditore, në drejtim të implementimit të politikave të reja për punë me njerëz me nevoja të posaçme. Së bashku me Ministrinë e Vetëqeverisjes Lokale organizuam Forumin e kryetarëve të komunave, me qëllim që të prezantojmë bashkëpunimin e vullnetarëve me komunat. Pesëdhjetë kryetarë komunash morrën pjesë në këtë eveniment dhe kjo rezultoi me rritje të numrit të interesuarve për bashkëpunim me komunat. Me Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës organizuam vizita në klasa inovative në shkollat e mesme dhe në një projekt për vullnetarizëm në komunitet. Më në fund, e përforcuam partneritetin me Byronë për Zhvillim të Arsimit, Qendrës Shtetërore për Provim dhe Zyra Rajonale për Bashkëpunim Rinor (RYCO).

Nënskruam Memorandum të ri për bashkëpunim me rrjetin e 20 klubeve Rotary në Maqedoninë e Veriut, kurse bashkëpunimi me Kryqin e Kyq dhe me Shoqatën e Skautëve vazhdon të zhvillohet, me çka hapen mundësi të reja për kyçje të vullnetarëve.

Shkurtimisht për Korpusin e Paqes



Në vitin 1961, Kryetari i Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Xhon F. Kenedi, formoi Korpusin e Paqes për të promovuar paqen dhe miqësinë botërore dhe sfidoi amerikanët për të jetuar dhe punuar në vendet në zhvillim. Kaluan më shumë se pesëdhjetë e tetë vjet nga formimi i Korpusit të Paqes, por misioni dhe roli i Korpusit të Paqes i bëri ballë testit dhe kohës. Tre qëllimet e Korpusit të Paqes mbeten po aq të rëndësishme aq sa ishin kur u formua ai:

Qëllimi 1: Të ndihmojë popujt e vendeve të interesuar të përmbushin nevojat për individë të trajnuar.

Qëllimi 2: Të promovojë kulturën dhe vlerat amerikane te vendet në të cilat vullnetarët shërbejnë.

Qëllimi 3: Të promovojë në Amerikë kulturën dhe vlerat e vendeve në të cilat vullnetarët shërbejnë.

Nga viti 1961, më shumë se 235 000 vullnetarët të Korpusit të Paqes kanë shërbyer në 141 vende, dhe kanë lënë trashëgimi vlera të përbashkëta, marrëdhënie të përmirësuara dhe zhvillim të qëndrueshëm në komunitet. Në vitin 2018 më shumë se 7300 amerikanë kanë qenë vullnetarë në 60 vende nëpër tërë botën.

Korpusi i Paqes në Maqedoninë e Veriut

Grupi: MAK 1, 1996

Korpusi i Paqes formoi programin e tij në Maqedoninë e Veriut në vitin 1996, me ftesë të Qeverisë së Maqedonisë së Veriut. Që atëherë, më shumë se 800 vullnetarë kanë shërbyer në shkolla, komuna, organizata qytetare dhe institucione publike për të përmbushur nevojat e ndryshme të komuniteteve në vend. Si mirënjohje për rëndësinë e Korpusit të Paqes për përmirësimin e miqësisë maqedonase-amerikane dhe për detyrimin dhe përkushtimin e vullnetarëve në shoqërinë maqedonase, kryetari i Maqedonisë së Veriut dhuroi Urdhërin e Meritës për Korpusin e Paqes në Maqedoni në vitin 2011.



Në vitin 2018 gjithsej 87 vullnetarë kanë shërbyer në njërin nga dy projektet e Korpusit të Paqes në Maqedoni, programin për përparimin e mësimdhënies së gjuhës angleze dhe programin për zhvillimin e komunitetit, me fokus të veçantë në të rinjtë dhe personat me aftësi të kufizuara.

Gjatë shërbimit të tyre në Maqedoni, vullnetarët njihen me kulturën lokale, mësojnë gjuhët lokale dhe në mënyrë aktive marrin pjesë në jetën shoqërore. Pas mbërritjes në Maqedoni, vullnetarët kalojnë nëpër një trajnim intenziv për gjuhën, kulturën dhe shkathtësitë teknike. Për të lehtësuar integrimin e tyre në komunitetet lokale, vullnetarët jetojnë me familje nikoqire lokale gjatë trajnimit fillestar, por edhe gjatë periudhës prej 6 deri 24 muaj të shërbimit të tyre. Korpusi i Paqes ka bërë implementimin e programit të tij në Maqedoninë e Veriut përmes bashkëpunimit direkt me disa partnerë shtetërore dhe lokal të cilët janë aktiv në sferën e arsimit, zhvillimin e komunitetit, punën me të rinjtë dhe personat me aftësi të kufizuara.



Në vitin 2018 Korpusi i Paqes në Maqedoninë e Veriut kishte memorandume aktive të bashkëpunimit me këta partnerë: Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës, Ministrinë e Vetëqeverisjes Lokale, Ministrinë e Punës dhe Politikës Sociale, Agjencinë e Rinisë dhe Sportit, Kryqin e Kuq, Këshillin Nacional Rinor të Maqedonisë, Koalicionin e Organizatave Rinore SEGA dhe Shoqatën e klubeve Rotary.

Grupi: MAK 23, 2018



Korpusi i Paqes në Maqedoninë e Veriut në vitin 2018:

Peace Corps

2 projekte të Korpusit të Paqes në Maqedoninë e Veriut - programi për përparimin e mësimdhënies së gjuhës angleze dhe programi për zhvillimin e komuniteteve

51 shkolla fillore dhe të mesme ku shërbyen vullnetarët

12 vullnetarë që shërbyen në organizata dhe institucione për njerëzit me nevoja të veçanta

87 vullnetarë të Korpusit të Paqes shërbyen në Maqedoninë e Veriut

13 kampe verore "Rreth botës" të organizuara në komunitetet rurale

126 organizata qytetare kanë punuar me vullnetarët

23 vite të Korpusit të Paqes në Maqedoninë e Veriut

134 arsimtarë të shkollave fillore dhe të mesme kanë bashkëpunuar me vullnetarët

39 projekte në komunitet, implementimi i të cilave është bërë përmes programit për grante të vogla të Korpusit të Paqes

383 persona me aftësi të kufizuara me të cilët kanë punuar vullnetarët

45 komuna në të cilat kanë jetuar dhe shërbyer vullnetarët

460 pjesëmarrës në kampet verore "Rreth Botës"

46 mësimdhënës punuan me vullnetarët në zhvillimin e metodologjive për punë me nxënës me nevoja të veçanta

7635 persona, shumica të rinj, të cilët ishin pjesë e aktiviteteve për pjesëmarrje në komunitet, fitimin e shkathtësive jetësore dhe vullnetarizëm

48 kryetarë komunash që morrëm pjesë në Forumin e kryetarëve të organizuar nga Korpusi i Paqes në Maqedoninë e Veriut

10881 nxënës të shkollave fillore dhe të mesme të cilët kanë mësuar gjuhën angleze me ndihmën e një vullnetari

Projekti i zhvillimit të komunitetit

Projekti i zhvillimit të komunitetit në Maqedoninë e Veriut mbështet komunitetet dhe organizatat në Maqedoninë e Veriut me qëllim të arritjes së një zhvillimi më efikas të qëndrueshëm të komuniteteve. Në vitin 2018 vullnetarët e Korpusit të Paqes kanë punuar me organizatat qytetare, komunat lokale dhe institucionet publike të vendit.

Qëllimet e projektit për zhvillimin e komunitetit në punën me partnerët lokalë janë përmirësimi i kontributit të organizatave dhe grupeve joformale për identifikimin e nevojave të komunitetit; rritja e pjesëmarrjes së të rinjve në komunitet dhe zhvillimi i shkathtësive të të rinjve si persona dhe qytetarë aktivë; dhe forcimi i kapaciteteve të organizatave për të përmirësuar cilësinë e jetës së personave me aftësi të kufizuara.

Në vitin 2018 Korpusi i Paqes në Maqedoninë e Veriut e zgjeroi rrjetin e partnerëve duke nënshkruar një Memorandum bashkëpunimi me Shoqatën e Rotary klubeve.

Gjithashtu Korpusi i Paqes e thelloi bashkëpunimin e tij me Shoqatën e Skautsave duke përforcuar më tej sferat e zhvillimit të të rinjëve, zhvillimin e aftësive jetësore të njerëzve të rinj; poashtu promovimin e punës vullnetare në komunitetet lokale.



Vullnetarët për zhvillim të komunitetit në Maqedoninë e Veriut dhe bashkëpunëtorët e tyre lokal në vitin 2018 iu dhanë përparësi pojekteve në vijim:

- Mbështetja e organizatave në përcaktimin e nevojave të komunitetit dhe ndërtimi i partneriteteve strategjike për t'ju përgjigjur nevojave të identifikuar;
- Përmirësimi i shkathtësive të punonjësve në fushat e rëndësishme për zhvillimin organizativ;
- Trajnimet e qytetarëve me qëllim të pjesëmarrjes së tyre në komunitet dhe fitimit të shkathtësive jetësore, si dhe ngritjes së ndërgjegjes për personat me aftësi të kufizuara;
- Lehtësimi dhe organizimi i aktiviteteve për zhvillimin e shkathtësive jetësore tek të rinjtë, klubet rinore dhe kampet GLOW dhe YMLP, programet e udhëheqjes qytetare, Modelin e Kombeve të Bashkuara

2

projekte në Maqedoninë e Veriut

Projekti i zhvillimit të komunitetit — Punë me persona me nevoja të veçanta

Korpusi i Paqes në Maqedoninë e Veriut përkrah përpjekjet për përfshirje shoqërore në të gjithë vendin, duke fokusuar punën e tij në përmirësimin e kapacitetit të organizatave/shkollave në përmirësimin e kualitetit të individëve me nevoja të veçanta; dhe duke përforcuar shkathtësitë jetësore dhe nivelin e përfshirjes shoqërore për individët me nevoja të veçanta.

Vullnetarët bashkëpunojnë me defektologë lokal dhe arsimtarë për zhvillim të trajnimeve, teknikave dhe materialeve për punë me persona me nevoja të posaçme, të synuara për fëmijë dhe të rritur. Shumë nga vullnetarët mbështesin edhe aktivitete për bashkësit lokale për ngritje të vetëdijes për kyçe të personave me nevoja të posaçme në bashkësinë lokale.



Vullnetarët për nevoja të veçanta punojnë në shkolla publike, në shkolla speciale, qendra ditore shtetërore për persona me nevoja të veçanta dhe qendra ditore të udhëhequra nga OJQ.

Me mbështetjen e stafit lokal, Vullnetarët për nevoja të veçanta u fokusuan në aktivitetet në vazhdim:

- Zhvillimi i planeve mësimore dhe burimeve për mësimdhënie;
- Mësimdhënia me edukatorë specialë;
- Krijimi i aktiviteteve të reja mësimore për shkathtësi jetësore dhe pune për personat me nevoja të veçanta;
- Trajnimi i stafit për shkathtësitë e punës, menaxhimin e sjelljes, mjeteve të vlerësimit, metodologjitë e punës dhe zhvillimin e burimeve;
- Ndihmë për punëtoritë kreative me shfrytëzuesit dhe stafin.

Vullnetarët e mbështesin punën me fëmijë dhe të rritur me nevoja të posaçme në organizatat e tyre dhe së bashku me bashkëpunorët organizojnë edhe aktivitete për ngritje të vetëdijes në shoqëri.

2

projekte në Maqedoninë e Veriut

Projekti për përparimin e mësimdhënies në gjuhën angleze

Korpusi i Paqes në Maqedoninë e Veriut bëri implementimin e programit për përparimin e mësimdhënies së gjuhës angleze në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës së Maqedonisë së Veriut, me Byronë për Zhvillimin e Arsimit dhe Qendrën Shtetërore të Provimeve, si dhe me agjenci dhe organizata të cilat janë përkushtuar për përmirësimin e mundësive arsimore. Në vitin 2018 vullnetarët kanë punuar në shkollat shtetërore fillore dhe të mesme të vendit, me theks në komunitetet rurale dhe të marginalizuara. Vullnetarët kanë ndihmuar arsimtarët e gjuhës angleze në mësimdhënie duke futur metoda për vënien e nxënësve në qendër të orës dhe për organizimin e orës, si dhe kanë dhënë ndihmë me klasat e përziera.



Qëllimet e programit për përparimin e mësimdhënies në gjuhën angleze janë: përmirësimi i cilësisë së mësimdhënies në shkolla, rritja e suksesit të nxënësve në të mësuarit e gjuhës angleze dhe përmirësimi i komunitetit shkollor. Me kërkesën e Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës dhe Byrosë për Zhvillimin e Arsimit, Korpusi i Paqes ka organizuar trajnime për arsimtarët e gjuhës angleze për punën me nxënësit me aftësi të kufizuara në orët e gjuhës angleze.

Aktivitetet e mëposhtme ishin prioritet i vullnetarëve të Korpusit të Paqes dhe i bashkëpunëtorëve të tyre-arsimtarë në vitin 2018:

- Ligjëratë e përbashkët me arsimtarët e gjuhës angleze;
- Futja e metodave për vënien e nxënësve në qendër të orës mësimore;
- Përgatitja e materialeve për orën mësimore;
- Mbështetja e arsimtarëve në zhvillimin e metodologjisë së punës me nxënësit me aftësi të kufizuara;
- Mësimdhënie në anglisht jashtë shkollës, në klube dhe aktivitete të tjera të lira;
- Të ndihmuarit e shkollave me aktivitete të projektit.

23

vite të Korpusit të Paqes në Maqedoninë e Veriut

Vizita e Xhodi Olsen - Drejtoresha e Korpusit të Paqes

Korpusi i Paqes në Maqedoninë e Veriut përjetoj shumë ndryshime dhe ngjarje pozitive në vitin 2018. Tani që po shkelim në vitin tonë të 23-të, kjo na jep kohë të reflektojmë për të gjitha arritjet dhe partneritetet që i kemi bërë. Në prill të vitit të kaluar, ne e mirëpritëm në Shkup drejtoreshën e re të Korpusit të Paqes Xhodi Olsen dhe 17 drejtorë nga rajoni për një konferencë vjetore për të shkëmbyer praktikat më të mira. Pjesa më e rëndësishme e konferencës ishin vizitat që iu bënë vullnetarëve në fshatra dhe qytete në të cilat ata në mënyrë aktive ligjerojnë gjuhë angleze, punojnë me popullatën me nevoja të veçanta dhe ndërtojnë udhëheqësi rinore përmes zhvillimit të komunitetit.



Udhëtimi për në Maqedoninë e Veriut ishte udhëtimi i parë zyrtar në një post të Korpusit të Paqes në kapacitetin e saj zyrtar. Si drejtoreshë ajo mbikëqyr 61 programe të vendeve dhe mbi 6500 vullnetarë që punojnë për të sjellë Shtetet e Bashkuara më afër botës. Gjatë kësaj jave, Drejtoresha Olsen kishte një takim me Kryeministrin Zoran Zaev i cili falënderoi Korpusin e Paqes që punon në Maqedoninë e Veriut që nga viti 1996. Ai personalisht mikpritë disa vullnetarë derisa ishte kryetar komune i Strumicës dhe ai përkujtoi për Drejtoreshën Olsen vlerësimin e tij për punën e vullnetarëve në Komunën e tij të mëparshme dhe miqësitë që ai kishte bërë gjatë viteve. Drejtoresha Olsen vizitoi disa vullnetarë nëpër gjithë vendin në qytete dhe fshatra siç janë vullnetari i Korpusit të Paqes Austin në Gorno Lipkoviç jashtë Radovishit dhe vullnetaren e Korpusit të Paqes Emily në Rostushe brenda parkut të bukur të Mavrovës.

Ajo ishte tepër e impresionuar nga përkushtimi i stafit të Korpusit të Paqes dhe vullnetarëve. Ajo komentoi që vullnetarët integrohen mirë, mësojnë gjuhën, zënë miq dhe bëjnë një ndikim. Pasi që u kthye në Uashington, Drejtoresha Olsen iu referua udhëtimit të saj në Maqedoninë e Veriut në disa fjalime mbi efektivitetin e vullnetarëve në fushë. Ishte një nder i madh që Drejtoresha Olsen zgjodhi Maqedoninë e Veriut si udhëtimin e saj të parë jashtë vendit.

Pasurimi i jetëve përmes ndërhyrjes, aktivitetit dhe përfshirjes - Lauren Xhajëlls



Qëllimi i këtij granti ishte përmirësimi i cilësisë së jetës dhe ofrimi i mundësive rekreative për shfrytëzuesit me nevoja të veçanta në një qendër ditore qeveritare. Duke blerë pajisje dhe furnizime, fëmijëve dhe të rriturve iu dha qasje në muzikë, art dhe sporte, si dhe instruksion dhe ndërhyrje e përmirësuar.

Projekti është në vazhdim e sipër, por rezultatet shqyrtohen në bazë ditore përmes rritjes së shkathtësive shoqërore nga luajtja e lojërave bashkëpunuese dhe aktiviteteve si pingpong, football, boçia, dhe lojërave me karta, dhe përmes shkathtësive të përmirësuar jetësore dhe funksionale nga ndërhyrja e mëngjesit dhe instruksionit një më një. Studentët e kanë mirëpritur këtë projekt, dhe e tregojnë këtë kur ata kanë mundësi që në mënyrë të pavarur të marrin, ose të kërkojnë materialet që u nevojiten për një aktivitet, ose e sjellin kutine e tyre të ndërhyrjes tek mësuesi që t'i tregojnë që janë të gatshëm të punojnë!

Komuniteti e ka përkrahur dhe mirëpritur këtë projekt, me një trajnim të suksesshëm për tinxherët që janë vullnetarë në qendër përmes Kryqit të Kuq, si dhe ndihma me projektet e arteve, lojërave dhe me ndihmën në krijimin e materialeve ndërhyrëse.



Zhvillimi i aktiviteteve në qendrën për resurse të gjuhës angleze që kanë në qendër nxënësin - Aleksa Çamberlin

Si pjesë e këtij projekti, bashkëpunëtorët e mi dhe unë krijuam një klasë me materiale në gjuhën angleze duke rimodeluar një dollap magazinimi. Qëllimi i këtij projekti ishte të zhvillojë materiale që kanë në qendër nxënësin, derisa krijonte një hapsirë që ishte angazhuese për nxënësit. Mësuesit morrën një dërrase interaktive, libra dhe pajisje për klasën.

Unë mbajta dy punëtori për t'i mësuar të përdorin teknologjinë e re dhe të zhvillojnë materiale që kanë në qendër nxënësit. Bashkëpunëtorët e mi filluan të krijojnë lojëra, projekte për punë në grup, vepra artizanale për të mësuar gramatikë dhe i plastifikuan materialet që t'i përdorin në vitet në vazhdim. Ata krijuan materiale që krijuan një ambient

ku nxënësit i udhëhiqnin projektet e jo mësuesit. Gjatë vitit shkollor, filluam të shihnim ndryshim tek nxënësit tanë. Nxënësit vinin në klasë më të motivuar, të gatshëm të participojnë dhe silleshin më mirë në klasë. Besojmë që kjo ndodh për shkak të aktiviteteve të reja që kanë në qendër nxënësin.



Bashkëpunëtorja ime Marina, mbajti punëtorinë finale me stafin. Ajo e mësoi stafin si të krijojnë materialet e tyre me qendër nxënësin dhe të krijojnë mësimet e veta në dërrasën interaktive. Pas punëtorisë, stafi filloi të përdorë klasën dhe të krijojnë materiale. Mësuesit besojnë se ky grant ishte i suksesshëm dhe për shkak të kësaj, ne po zhvillojmë një grant të dytë për të krijuar një bibliotekë më të qëndrueshme për nxënësit.

Marina për klasën e re tha, “Dhoma e burimeve në gjuhën angleze ishte diçka e re për shkollën, nxënësit dhe mësimdhënien time. Ky ishte një ndryshim pozitiv në mënyrën që unë jap mësim. Unë mund të mbështetem në materialet që kemi në klasë, që ndihmuan të bëjnë mësimdhënien time më angazhuese dhe të arrij më mirë tek nxënësit. Unë e di që ne bëmë një ndryshim kur i shoh nxënësit e mi të vijnë në klasë të ngazëllyer të shohin se çfarë do të mësojnë. Nxënësit tani e kanë mundësinë të mësojnë përmes teknologjisë, lojërave dhe aktiviteteve që kanë në qendër nxënësin që na u prezantuan nga vullnetarja jonë, Aleksa.”

Të krijojmë një të nesërme më të mirë, sot - Dejvid Krand



Unë arrita në Resnjë në dhjetor të 2018-ës si një nga 18 vullnetarët për zhvillimit të komuniteteve që punojnë në të gjithë vendin. Unë isha nga të paktët vullnetarë at vit që pilotuam qasjen e re të Korpusit të Paqes të të qenit vullnetarë “të bazuar në Komunitet”, që do të thotë të punosh me dy nga më shumë vende pune primare. Vendet e mia të punës ishin dega e Kryqti të Kuq lokal në Resnjë dhe një OJQ për zhvillimin e të rinjëve ‘Akcija Plus’.

Gjatë punës me bashkëpunëtorët e mi, detyra ime fillestare ishte të zbuloj nevojat e të rinjëve lokal në Resnjë dhe t’u ndihmoj bashkëpunëtorëve të mi në përpjekjet për zhvillimin e të rinjëve në komunitet.

Krijimi i një rrethi dhe partneriteteve të reja u bë një aspekt tjetër i rëndësishëm i punës sime. Në pranverë të 2018-së, ne filluam të implementojmë projektin “Një të nesërme më të mirë, Sot” me qëllim të ngritjes së vetëdijes për diabetin dhe prevenimin e tij përmes dietës së shëndetshme dhe zgjedhjes së stilit të jetës. Projekti përbëhet nga një libër gatimesh, të shkruar në të tre gjuhët e folura lokale, një seri punëtorish dhe orëve të gatimit, dhe librat e gatimit iu shpërndanë mbi 500 anëtarëve të komunitetit. Ky projekt nuk adreson vetëm një problem vital shëndetësor publik, por ka bashkuar një sërë palësh të interesuara nga komuniteti, përfshirë dy OJQ, Kryqin e Kuq në Resnjë dhe Action Plus në Resnjë; bashkë me mjekë, nutricioistë, mësues të shkollave fillore, dhe Shoqatën e Pensionerëve. Projekti është një shembull shumë i mirë se si me lidhjen dhe bashkimin e fuqive, i gjithë komuniteti mund të ndihmojë në ngjitjen e vetëdijes për

Si shtesë e dy vendeve primare të punës, unë gjithashtu jam aktiv në një shkollë të mesme dhe fillore në Resnjë, ku unë punova me mësuesit të zhvillojmë idenë e ‘Prespa Youth Club’. Së bashku me vullnetarët e rinj të Kryqit të Kuq, unë ndihmova të organizojmë kualifikimin e parë për Spelling Bee në një shkollë fillore në fshatin Podmoçani. Në komunitetin tim unë ndihmoj në qendrën ditore lokale dhe gjithashtu kam orë bisede në gjuhën angleze një herë në javë me anëtarët e interesuar të komunitetit. Njerëzit me të cilët punoj duket se e çmojnë qasjen time pozitive dhe janë të frymëzuar të krijojnë një të nesërme më të mire, sot.

Në mars të vitit 2018, Korpusi i Paqes në Maqedoninë e Veriut organizoi forumin e parë të Kryetarëve të Komunave, një ngjarje që bashkoi rreth 50 kryetarë të komunave dhe përfaqësues të tjerë të qeverisjes lokale, si pjesë e strategjisë së tij të promovimit dhe identifikimit të vendbanimeve. Gjatë forumit të Kryetarëve të Komunave, Korpusi i Paqes ndau sukseset e tij nga periudha e kaluar dhe zyrtarisht lëshoi Thirrjen për Aplikime.



Në ngjarje, Kryetarët e Komunave kishin mundësinë të dëgjojnë dhe takojnë vullnetarët që punojnë në Komuna, shkolla dhe në sferën e nevojave të veçanta. Ata gjithashtu dëgjuan dëshmi nga Kryetarët e Komunave dhe bashkëpunëtorët të cilët punojnë me vullnetarë të Korpusit të Paqes në të gjithë vendin.



Gjatë këtij forumi, drejtori i Korpusit të Paqes në Maqedoninë Veriore, Mark Hanaffin, dhe Ambasadori i Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Jess Baily, dhanë një pasqyrë të trashëgimisë së Korpusit të Paqes në Maqedoninë e Veriut deri më tani. Ministria e Vetëqeverisjes Lokale, si një nga partnerët shtetërorë të Korpusit të Paqes në Maqedoninë e Veriut, dha mbështetje të vlefshme në organizimin e forumit dhe Ministri Suhejl Fazliu iu adresua pjesëmarrësve duke shprehur

përkushtimin e Ministrisë për të bërë partneritet me Korpusin e Paqes dhe për të qenë pjesë e shkëmbimit ndër-kulturor dhe profesional në mes të dy shteteve, veçanërisht në nivel lokal.

“Përvoja juaj është tepër e vlefshme për ne. Neve na nevojitet entuziazmi juaj. Vetëm me ndarje të njohurive, përvojës, miqësisë dhe bashkëpunimit ne mund të ndërtojmë vlera të përbashkëta dhe të bashkëpunojmë, të jemi tolerant, të njerëzishëm dhe mbi të gjitha qytetarë të përgjegjshëm të cilët i duan komunitetet e tyre dhe qytetarët e vet, pa marrë parasysh përkatësinë e tyre etnike, religjioze ose gjuhësore, ose çfarëdo lloj përkatësie tjetër”, - tha Ministri Fazliu.

51

shkolla fillore dhe të mesme ku vullnetarët shërbyen

Sukseset e vullnetarëve - Endru Gardner

Gjatë shërbimit tim, unë kam kaluar një kohë të mrekullueshme duke mësuar, bashkëvepruar dhe njohur nxënësit në shkollën time. Fëmijët në të gjitha klasat vijnë në shkollë çdo ditë me një pikëpamje pandërprerë të ndritshme dhe ngazëllim për nxënien, që me të vërtetë të ngre shpirtërisht dhe moralisht. Derisa shkolla jonë nuk ka shumë gjëra, bashkëpunëtori im dhe unë kemi pasur shumë sukses duke bërë më të mirën me mjetet e kufizuara dhe materialet që kemi në dispozicion në shkollën tonë gjatë orëve tona; kjo na mundëson neve të kemi mësimet interaktive që u ndihmojnë nxënësve të angazhohen me anglishten në mënyra që ata nuk janë mësuar. Ne kemi gjëra të inkuorpuara siç janë këngë dhe vallëzim, film, gjueti për gjëra, dhe bërja e kartolinave në orët tona, një gjë në të cilën nxënësit tanë nuk kishin qasje ishte letërsia në gjuhën angleze. Secili nxënës ka një libër leximi në anglisht, por vetëm kaq; shkolla jonë ka një bibliotekë të vogël, por në të ka vetëm letërsi në gjuhën maqedonase. Nuk ka libra për fëmijë për kohën e tregimeve me nxënësit e klasave të ulta, nuk ka romane për të rinjtë për fëmijët tanë më të mëdhenj. Të vetmen anglisht në të cilën kishin qasje nxënësit tanë ishte ajo që kishin në librat e tyre të leximit në gjuhën angleze dhe në telefonat e tyre, që do të thotë që ata humbin shumë nga bota e anglishtes, një botë e cila ekziston në libra.



Bashkëpunëtori im dhe unë, duke parë se sa kjo i pengon nxënësit tanë, vendosëm të bëjmë diçka për këtë. Pas disa muajsh që u shkruam organizatave të ndryshme ndërkombëtare që dhurojnë libra, ne pranuar dy donacione të mëdha librash në shkollën tonë në Jabllanicë. Pasiqë morëm librat ne ndërtuam një raft librash, duke përdorur materiale të donuara nga fshati, dhe patëm ndihmë të madhe nga dy vëllezër nga komuniteti. Rafti i librave ishte gati pas një jave pune të lodhshme, dhe pastaj e vendosëm në një klasë të zgjedhur paraprakisht në shkollë. Pasiqë e vendosëm raftin e librave, biblioteka jonë e vogël por e harmonishme e anglishtes u lëshua për përdorim. Nxënësit tanë, duke përdorur një sistem të thjeshtë të marrjes dhe kthimit të librave, kanë mbi 120 libra në gjuhën angleze në dispozicion në bazë ditore tani.

Biblioteka është e hapur në kohë të caktuar çdo ditë dhe nxënësit tanë gjithmonë me dëshirë presin shansin të kthejnë librin e tyre të përfunduar që të marrin një të ri. Nxënësit inkurajohen të shkruajnë një përmbledhje të asaj që kanë lexuar, ose të bëjnë një prezantim të shkurtër nëse preferojnë. Kjo përzgjedhje e vogël e librave në gjuhën angleze u ka dhënë nxënësve mundësinë të praktikojnë anglishten e tyre jashtë shkollës, të pavarur, të zgjerojnë horizontet e tyre, dhe gjithashtu u ndihmon të zhvillojnë dhe ushqejnë kuriozitetin dhe kreativitetin e tyre. Gjithashtu, e kemi inkuorpuar bibliotekën në gjuhën angleze në mësimet tona dhe klubet pas shkolle. Përmes punës në ekip, bashkëpunimit pozitiv të komunitetit dhe me pak më shumë punë, bashkëpunëtori im dhe unë kemi menaxhuar të sjellim pak më shumë anglisht në jetët e nxënësve tanë.

87

vullnetarë të Korpusit të Paqes shërbyen në Maqedoninë e Veriut

Brenda Faust - pjesë e programit special të Korpusit të Paqes

Programi special “response” i Korpusit të Paqes është një iniciativë që ndihmon të plotësoj nevojat e vendeve nikoqire për ndihmesë teknike në sferat që ka nevojë. Vullnetarët Response kanë aftësi të specializuara dhe përvojë të mjaftueshme profesionale dhe prandaj veprojnë si konsultantë teknik për të dhënë të dhëna dhe mbështetje në projekte afat-shkurtëra me ndikim të madh.

Korpusi i Paqes në Maqedoninë e Veriut rekrutoi vullnetaren Response Brenda Foust të shërbejë si një specialiste vlerësimi në Qendrën Shtetërore të Provimeve (QSHP) në Maqedoninë e Veriut, duke u fokusuar në përmirësime specifike të provimit të lëndës së gjuhës angleze të Maturës Shtetërore. Angazhimi i Brendës në QSHP ishte një vjeçar.



Brenda dhe bashkëpunëtorja e saj nga QSHP, Trajanka Avramoska bënë punë të rëndësishme në projektin për përmirësimin e cilësisë së provimit të gjuhës angleze në Maturën Shtetërore të Maqedonisë. Pjesë e punës së tyre ishte rishikimi i provimit dhe katalogut të provimit, përforcimi i cilësisë së përmbajtjes së provimit, përgatitja për testin e dëgjimit, rezultatet dhe analiza e rezultateve, dhe propozuan ndryshime për proceset dhe politikat.

Kjo përpjekje u bë në partneritet me Qendrën Shtetërore të Provimeve dhe ishte e fokusuar në përmirësimin e përmbajtjes së testeve dhe ndërtimit të kapaciteteve për seksionin e aftësive të dëgjimit në test.

126 OJQ me të cilat punuan vullnetarët

Dëshmia e Blazhe Josifovskit – bashkëpunëtor i vullnetarit

Unë kam pasur kënaqësinë të punoj me një vullnetar të Korpusit të Paqes gjatë dy viteve të fundit dhe ka qenë një marrëdhënie vërtetë bashkëpunuese. Kameron Bertel arriti në organizatën tonë “Ajde Makedonija” me një vendosmëri dhe vullnet për të vënë shpirtin e vërtetë të shërbimit të Korpusit të Paqes në vepër. Bashkëpunimi që kemi pasur ka çuar në sukses të mahnitshëm në zhvillimin dhe implementimin e një programi që çonte ushqimin e tepërt nga deponitë të redistribuohet tek qytatarët që nuk kishin ushqim. Përmes përkushtimit të Kamerorit, ne mundëm të siguronim një grant SPA nga Korpusi i Paqes për të finansuar web platformën tonë të redistribuimit të ushqimit të tepërt.



Kjo platformë ia ka mundësuar Ajde Makedonija të arrijë te mijëra njerëz në nevojë për ushqim në Maqedoni dhe t'i furnizojë ata me mbi 65 tonelata të ushqimit tepërcë me vlera ushqyese.

Gjatë kohës që kam punuar me Kameroron dhe Korpusin e Paqes, kam qenë i inspiruar të pranoj shpirtin optimist dhe sipërmarrës prezent te Vullnetarët e Korpusit të Paqes, siç është Kameroni. Përvojat me të në zyrë më kanë demonstruar përfitimin e madh të shkëmbimin ndër-kulturor që Korpusi i Paqes mund të ofrojë. Mësimet që Kameroni dhe unë ia kemi mësuar njëri-tjetrit kanë lënë përshtypje që zgjasin dhe do të barten në karrierat tona të ardhshme. Jam tepër mirënjohës për këtë përvojë.

Dëshmia e Natasha Avramovskës – bashkëpunëtore e vullnetarit

Gjatë dy viteve të fundit, Dedo Ilijo Malesevski, një shkollë fillore në Berovë me mbi 700 nxënës, 107 të punësuar dhe 7 shkolla satellite, ka qenë me fat të ketë një Vullnetare të Korpusit të Paqes për mësimdhënien e gjuhës angleze. Vullnetarja jonë e dashur i ka dhënë një kontribut të mahnitshëm stafit tanë, puna e saj në projektin e bibliotekës së anglishtes dhe kontributet e saj në *eTwinning*, *HIPPO* dhe *SID* janë tepër të çmueshme. Me pjesëmarrjen dhe bashkëpunimin e saj me mësimdhënësit tanë, ne jemi rritur si një shkollë progresive dhe ndërkombëtare.



Gabriela ka qenë një nder për nxënësit tanë, me të cilët ajo punon në shkollë dhe jashtë saj. Puna e saj me kampin GLOW dhe kampin YMLP ka qenë shumë e mirë për nxënësit tanë. Duka ua mundësuar atyre të shprehin dhe ushqejnë kreativitetin e tyre, interesat dhe njohuritë, si dhe të jetë një ndikim pozitiv në komunitet.

Ne jemi shumë të lumtur që ajo ka vendosur të zgjasë qëndrimin e saj edhe për një vit; memzi presim të shohim çfarë ka në horizont dhe çfarë mund të arrijmë

më shumë. Mezi presim për bashkëpunimin tanë të vazhdueshëm me Korpusin e Paqes.

Sukseset e vullnetarëve - Erin Finell

Unë punoj në një qendër ditore që shërben rreth 12 individë me të aftësive të kufizuara. Për shumë nga shfrytëzuesit e mi, shkuarja në qendër është mundësia e tyre e vetme për të pranuar ca stimulim mendor dhe shoqëror. Për këtë arsye, bashkëpunëtori im dhe unë gjithmonë mendojmë për aktivitete të reja që do ta bëjnë kohën e tyre në qendrën ditore më të vlefshme dhe të kënaqshme.

Kohët e fundit, ne kemi prezantuar gatimin si një aktivitet që e bëjmë me shfrytëzuesit rreth dy herë në muaj. Kjo ka qenë një mënyrë e shkëlqyer për të inkorporuar qëllimet e Korpusit të Paqes, derisa gjithashtu qëndrojmë të fokusuar në stimulimin mendor dhe shoqëror të shfrytëzuesve. Bashkëpunëtori im dhe unë ndajmë kohë të takohemi dhe diskutojmë cilën reçetë do të bëjmë – gjithmonë është ose një reçetë tradicionale maqedonase ose një ushqim që është tradicional amerikan.



Shfrytëzuesit pastaj ulen rreth një tavoline dhe me radhë i shtojnë përbërësit, përziejnë dhe provojnë ushqimin. Tani që gatimi bëhet një aktivitet më konsistent, unë po punoj në përfshirjen e të gjithë shfrytëzuesve, pa marrë parasyshë nevojat e tyre. Kjo është bërë një mënyrë që unë të modeloj metodat e përfshirjes dhe dallimit për bashkëpunëtorin tim, poashtu edhe të theksoj qëllimin tim që të gjithë njerëzit me aftësi të kufizuara meritojnë të përfshihen.

Në përgjithësi, gatimi me shfrytëzuesit dhe bashkëpunëtorin tim ka qenë një mundësi të ndaj diçka që mua më pëlqen të bëj. Kjo ka bërë që të shkëmbejmë kulturat, t'i mësojmë shfrytëzuesit për renditjen, numrat dhe ndarjen, mësimin e mënyrave të reja për të përfshirë të gjithë, dhe përfundon duke shijuar diçka të shijshme!



Peace Corps
NORTH MACEDONIA

2018 - ta me numra

87

vullnetarë të Korpusit të Paqes
shërbyen në Maqedoninë Veriore

10,881

nxënës që mësuuan
nga vullnetarë



51

shkolla ku
shërbyen
vullnetarë



134

arsimtarë që bashkëpunuan
me vullnetarë





13

kampe "Rreth
botës" me

460

pjesëmarrës



7,635

persona morën pjesë në
aktivitete të komunitetit



383

persona me
nevoja të
posaçme
punuan me
vullnetarë




126

organizata
qytetare
punuan me
vullnetarë




\$57,029

të siguruar nga
Korpusi i Paqes



\$41,310

kontribut i dhënë
nga bashkësitë
lokale



23%

e vullnetarëve
jetuan nëpër
fishatrra